



Z. Flamur Mrasori u lind më 5.9.1983 në Gjakovë. Në vitin 2005, ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë studimeve mori çmimin “Student i Dalluar” i Universitetit të Prishtinës. Në vitin 2008 ka përfunduar studimet Master në të njëjtin Universitet. Në vazhden e avancimit akademik, në vitin 2016, z. Mrasori ka përfunduar studimet e doktoratës në fushën e së Drejtës Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës. Aktualisht është Profesor në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, Departamenti i së Drejtës Ndërkombëtare me fokus “E Drejta e Unionit Evropian” dhe “E Drejta Ndërkombëtare Private”. Gjatë karrierës së tij akademike, z. Mrasori ka publikuar punime të ndryshme shkencore nga lëmi i jurisprudencës dhe integritimeve evropiane, si dhe ka qenë pjesëmarrës i një numri të konsiderueshëm konferencash ndërkombëtare, trajnimesh dhe punëtorish të ndryshme që ndërlidhen ngushtë me lëmin e jurisprudencës dhe integritimeve në përgjithësi dhe integritimeve financiare në veçanti.

Z. Mrasori ka punuar në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës për mbi 11 vite, ku ka ushtruar funksione të rëndësishme. Punën në BQK e ka filluar në vitin 2007, në mbikëqyrje financiare për të kaluar pastaj në pozitën e Shefit të Kabinetit të Guvernatorit. Nga viti 2013, z. Mrasori ka shërbyer si Këshilltar i Përgjithshëm i Guvernatorit dhe Sekretar i Bordit Ekzekutiv të BQK-së. Gjatë periudhës së shërbimit të tij në BQK, ai ishte i përfshirë në të gjitha proceset e rëndësishme për realizimin e objektivave të BQK-së. Si Kryesues i Komisionit për Integritime Evropiane të BQK-së, z. Mrasori ishte pjesëmarrës në procesin e negociimit të MSA-së ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Po ashtu, z. Mrasori ishte pjesëmarrës i rregullt i delegacionit të BQK-së në takimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore që nga anëtarësimi i Republikës së Kosovës në këto institucione.

Më 26 janar 2018 z. Mrasori është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa më 5 shkurt 2018 është emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pozitën e Anëtarit Joekzekutiv të Bordit të BQK-së.

Më 22 mars 2018, me votim unanim, z. Mrasori është zgjedhur Kryetar i Bordit të BQK-së.

Z. Mrasori është i martuar dhe ka dy vajza.